

Procesverbal

Nga seanca e III-të(tretë)/2019 e Kuvendit Komunal të Dragashit, e mbajtur më 02.04.2019, duke filluar në ora 10.00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit nga seanca e II-të/2019 e KK-së Dragash..,
2. Shqyrtimi dhe Raportit Vjetor Financiar, për vitin 2018...,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Pranit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Dragashit, për vitet 2019-2023...,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i P/Vendimit për bartjen e mjeteve të pa shpenzara vetanake, nga vitet 2017 e 2018, në vitin 2019...,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i P/Vendimit për ndërrimin e pronës së paluajtëshme të Komunës, në pronësi të pronarit, për ndërtimin e shkollës në fshatin Buçe...,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i P/Vendimit për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtëshme të Komunës në ZK Restelicë., dhe
7. Eventuale... (shtyhet për senacën tjetër).

Seancën, me përshëndetjen e të pranishmëve... e hapi kryesuesi i KK-së Dragash z.Betim Merdiu, me kërkesën dhe deklarinimin e delegatëve, nëse ka vërejtje apo plotësime të rendit të ditës, të dërguar me Ftesë...? Nëse nuk ka, miratojmë, njëzëri, rendit e ditës-sipas Ftesës...

z.Zinaida Elmazi- Në KPFinanca, kam propozuar që, në rend dite të seancës së radhës, të jetë çështja e deponive të shumëta ilegale e në pjesën e trevës së Gorës, që e kërkoj edhe tani?

z.Kryesuesi- Në rregull, konstatoj se miratuma rendin editës, me këtë sugjerim-kërkesë.

Pika e I-rë (parë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën dhe, si zakonisht, fillimisht, kemi shqyrtimin dhe miratimin e Procesverbalit nga senca e II-të/2019, nëse ka vërejtje apo plotësime...? Nëse nuk ka, e miratojmë edhe Procesvebrbalin e seancës së kaluar-II/2019.

Pika e II-të (dytë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me pikën e II-të të radhës ku kemi shqyrtimin dhe miratimin e Raportit Vjetor Financiarë/2018, që, fillimisht, do të na njofton kryetari i Komunës z.Shaban Shabani- ..."

" Bazuar në nenin 58 pika J e Ligjit 03-L/40 mbi Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.20/2008 të datës 04.06.2008) dhe nenin 45.4 të Ligjit 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/2008 të datës 03.06.2008), paraqes një përmbledhje të shkurtër të raportit vjetor financiar për realizimin e buxhetit janardhjetor 2018. Raportet financiare tregojnë informacione lidhur me buxhetin, rrjedhën e parasë së gatshme, të hyrat, pagat, shpenzimet për mallra dhe shërbime, shërbimet komunale, subvencionet dhe transferet, dhe shpenzimet për investime kapitale Ky Raport financiar prezanton të hyrat dhe shpenzimet e vitit 2018 dhe bënë krahasimin me 2 vitet paraprake.

Të nderuar asambleist, buxheti për vitin 2018 është miratuar në Kuvendin Komunal në shumën prej 8,069,990.00 euro, pas bartjes së të Hyrave Vetanake të paszpenzuara të vitit 2017 në shumën prej 637,935.10 euro dhe të hyrave nga Fondi i Donatoreve të viteve paraprake në shumën prej 13,028.65 euro, buxheti komunal arrinë shumën 8,720,953.75 euro. Në përfundim të vitit fiskal 2018, pas përmbushjes së obligimeve mbi pagat dhe shtesat, për shkak të nënshpenzimit të mjeteve, Ministria e Financave, në harmoni me dispozitat e Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike, ka bërë reduktimin e fondit të përgjithëshëm te kategoria buxhetore e pagave dhe shtesave për 59,160.92 euro, pas këtij veprimi të Ministrisë, buxheti i komunës ka pësuar ndryshime duke u zvogëluar për shumën e reduktuar dhe ka marr formën e re e që shuma totale e buxhetit final që arrinë në 8,665,321.72 euro. Sipas burimeve të financimit të buxhetit të Komunës së Dragashit, Fondi i Përgjithëshëm ka një pjesëmarrje prej 85.99 %, të hyrat vetanake fondi 21 dhe fondi 22: 12.68 %, financimi nga huamarrja: 1.18 % dhe fondi i donatorve 0.15 %. Fondi i Përgjithëshëm i buxhetuar në shumën prej 7,450,967.51 euro është alokuar në tërësi dhe është shpenzuar në shumën prej 7,215,849.54 euro ose 96.85 % që është një shkallë shumë e mirë e realizimit. Shuma e paszpenzuara nga ky fond i janë kategoritë mallrave dhe shërbimeve, shërbimeve komunale dhe investimeve kapitale. Nga Granti Qeveritar- kategoria buxhetore e mallrave dhe shërbimeve është shpenzuar në shumën 722,639.98 euro ose 98.86 %, kategoria e investimeve kapitale është shpenzuar 1,900,649.95 euro ose 90.46 %, kategoria e shërbimeve komunale 105,151.10 euro ose 80.89 % dhe kategoria e subvencioneve është shpenzuar 19,270 euro ose 99.79 % Mjetet e buxhetuara nga të hyrat vetanake dhe të hyrat e bartura nga viti paraprak janë realizue në shkallë prej 305,621.1 ose 37.08, financimi nga huamarrja është realizuar në shumën 69,961.06 euro ose 59.30 %. Buxheti i komunës është realizuar në shkallë prej 87.61 %.

Pagat dhe shtesat: Në emër të pagave dhe shtesave, në vitin 2018, janë shpenzuar mjete në total prej 4,469,698.51 euro të gjitha këto mjete janë shpenzuar nga Fondi i Përgjithëshëm. Pagat e paguara në vitin 2018 janë më të larta për 5.11% në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo ngritje ka të bëjë me pagesën e përvojës në punë dhe pagesave të shtesave si dhe pagesa e shperblimit jubilar me rastin e daljes në pension të mësimëdhenseve dhe shërbyesve civil.

Shpenzimet per mallëra e shërbime: janë realizue në shumën totale prej 814,867.36 euro. Kjo shumë e realizuar paraqet 88.23 % të shumës së buxhetuar për këtë kategori buxhetore. Shuma e buxhetuar për mallëra dhe shërbime, nga të gjitha burimet e financimit është 923,570.23 euro. Shuma e pa shpenzuar nga kjo kategori është nga të hyrat vetanake të cilat mund ti shpenzojme gjatë vitit 2019. Shpenzimet e periudhës për mallëra dhe shërbime në raport me shpenzimet e periudhës së njëjtë raportuese, të vitit paraprak, janë më të larta për 14.49 %.

Shpenzimet për shërbime komunale(energji elektrike, uje, mbeturina dhe shpenzime të telefonisë fikse) janë planifikuar në shumën 130,000 euro ndersa janë shpenzuar 150,151.10 euro . Krahasuar me vitin paraprak janë më të ulta për 2.42 %.

Subvencionet dhe transferet- në fillim kanë qënë të planifikuara 24,663 pastaj me vendim të asamblesë dhe pas bartjes se te hyrave vetanake te pa shpenzuara nga vitet paraprake është rritur në 44,191 euro. Nga shuma e alokuar janë shpenzuar 44020 euro ose 99.61% Kjo kategori është shpenzuar per 0.24% më shumë se vitin e kaluar. Shpenzimet per investime kapitale të buxhetuara në shumën prej 2.479.564,72 euro janë realizue në shumën prej 2.122.459,15 euro

ose 85,60% e shumës së buxhetuar. Në shtojcë të Raportit keni Listën e projekteve kapitale të realizuara në vitin 2015 sipas burimeve të financimit. Të Hyrat vetanake të komunës mbledhen në dy forma, pra të hyrat vetanake të mbledhura drejtëpërdrejtë nga komuna, si aktivitet i komunës dhe të hyrat e inkasuara nga niveli qendror të cilat transferohen në komunë, si pjesë përbërse e të hyrave. Këto të hyra janë dënimet nga gjobot në trafik në procedurë mandatore dhe të shqiptuara përmes gjykatave dhe të hyrat nga Agjencioni i Pyjeve, ndërsa pjesa tjetër e të hyrave janë të hyra të cilat mbledhen nga taksat dhe ngarkesat e ndryshme, si dhe tatimi në pronë i cili tatim paraqet bazën kryesore të të hyrave vetanake. Të hyrat vetanake të periudhës raportuese arrijnë shumën prej 349.061,28 euro dhe paraqet 71,67% të planit buxhetor mbi të hyrat vetanake. Sipas kësaj, del se në këtë periudhë nuk është përmbush plani buxhetor i të hyrave për 28,33% ose shprehur në shumë absolute janë inkasue mjete më pak për 137.968,72 euro. Të hyrat vetanake të komunës, në raport me periudhën e njëjtë raportuese të vitit paraprak, janë më të ulta për 6,85%. Të hyrat vetanake të pashpenzuara nga fondi 21 dhe fondi 22 të cilat duhet të barten për shpenzime në vitin 2016 kapin shumën prej 317.731,82 euro. Kjo shumë është si rezultat i shumës së mjeteve vetanake të bartura nga viti 2014 në vitin 2015 dhe mjeteve të inkasuara në vitin 2015, duke i zbritur shpenzimet e realizuara nga burimet e mjeteve vetanake. Komuna ka kërkesa të painkasuara në shumën totale prej 1.837.746,39 euro nga kjo shumë mbi bazën e tatimit në pronë këto kërkesa arrijnë në 936.127,20 euro, nga taksat komunale në biznese 675.746,50 euro dhe mbi bazën e shfrytëzimit të pronës komunale – qiraja 225.872,69 euro. Detyrimet kontigjente të cilat pritet se mund të ndodhin arrijnë në 213 mijë euro”.

z.Samidin Xheladini- Te Raporti i realizimit të buxhetit/2018, menjëherë në fq.2 qëndron, decidivisht, se të gjitha shënimet e prezentuara janë të sakëta dhe të plota. Por, në fq.4, kemi disa ndryshime lidhur me pagat e shtesat, për 60 mijë euro, që në fq.10 në emër të kësaj kategorie të pagave shtesave janë paguar reth 4 milionë euro e që janë më të larta për 5% e që shënimet janë dashur të janë të sakta e jo të bëhen ndryshuara në pozicione të ndryshme. Kemi shtim të fondit të donatorëve për 109,57%, mallërat e shërbimet janë shtuar për 81 mijë euro dhe bartjen në mjetet e shpenzuara e që gjithësejtë janë 7% më të larta se vitin paraprak. Nga Granti Qeveritar pjesëmarrja ka qenë 7.450.967,51 euro ose 85,99%, mjetete vetanake janë planifikuar në 2018 në 460.657,00 euro ose 5,32%, finansimi nga huat 102.733,46 euro ose 1,8%, mjetet e pa shpenzuara vetanake, nga vitet paraprake ishin 637,935,10 euro ose 7,36% dhe mjetete e finansuara nga donatorët 13.028,65 euro ose 0,15%. Finansimi nga huat është shumë të cilën e merr MShëndetësisë nga institucionet ndërkombëtare financiare e që ua ndan komunave për t’u kënaqur nevojat e QKMF-ve, që do të thotë se Komuna e Dragashit nuk do të paguan për këthim e huasë nga buxheti komunal? Sa i përket kategorisë së mallërave shërbimeve, mund të them se brengos fakti se janë bërë shpenzime të mëdha e sidomos ato që u përkasin mëditjeve të zyrtarëve për akomodimin e tyre në vend dhe jasht. Sipas këtyre shpenzimeve, shifet se kemi reth 32 mijë euro e në kodin 13133 në emër të shpenzimeve, përkatësisht shpenzimeve tjera të udhëtimeve zyrtare në vend kemi 8.126,00 euro e pse këto shpenzime nuk janë treguar viteve të mëparshme, te kodi 13460-shërbimet e kontraktuara kemi dallim, krahasuar me vitet paraprake. Te kodi 13470-shërbime teknike për vitin 2018 janë 15.202,49 euro, më 2017 janë 3.471,00 euro, më 2016 janë 362,94 euro e që na dalin 500% më shumë. Te kodi 13501-mobiljet nën 1 mijë euro, më 2018 janë 14.508,59 euro, më 2017 janë 296,25 euro, më 2016 janë 8.656,40 euro. Te kodi 13503-kompjuterë nën 1 mijë euro, më 2018 janë 11.956,10 euro, më 2017 janë 2.901,00 euro dhe më 2016 janë 9.581,80 euro e çka u bë me Vendimin e Kuvendit lidhur me sigurimin e kompjuterëve (“lap-topave”) e që është obligues për t’u zbatuar nga ekzekutivi i Komunës? Pra, dëshiroj të dijmë se pse nuk u realizua ai Vendim i Kuvendit dhe të gjendet fajtori? Te kodi 13720-nafta për nxemje qendrore, që më 2018 ka qenë 86.625,79 euro, më 2017-146.380,61 euro, më 2016-76.199,68 euro dhe a ka parashtruar dikush Raport për këtë, apo kush është përgjegjës për këtë dallim në shpenzime të mjeteve karahasur me vitet paraprake? Te regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve kemi

dy shuma dhe pse qëndron ashtu – mirëmbajtja dhe sigurimi i automjeteve? Kur jemi te subvencionet kemi shumën prej 44 mijë eurove e ne, shpesh, flasim për transparencën e kurr nuk po na dërgohet Lista e tillë e shfrytëzuesëve, që kërkoj, zyrtarisht, të na dërgohet, që të dihet, saktësisht, se kush ka përfituar nga subvencionet? Brenga më e madhe e të gjithë neve janë investimet kapitale si psh. te kodi 31124 te objektet sportive, më 2018-47.875,00 euro, më 2017-87.612,49 euro dhe më 2016-79.893,12 euro e e ne dijmë gjendjen ekzistuese të objekteve e terreneve tona sportive. Pra, a ka ndërmarr dikush masa ndaj atyre që janë përgjegjës për t'u dënuar dhe filluar procedurat kundër personave të tillë? Te kodi 31690-paisje tjera, më 2018-14.450,00 euro, kurse për vitet tjera nuk ka shënime. Te kodi 31708-automjetet për ndihmën e shpejtë-39.800,00 euro e ne kemi informata se ky automjet është tejet i dëmtuar e që organet kompetente duhet të konstatojnë gjendjen se a është kjo propagandë apo gjendje faktike?! Te kodi 33200 në emër të transferit të kapitalit, për entitetet publike kemi shumën prej 82.740,00 euro e në vitet e mëparshme gjendja 0 : 0? Po ashtu, te kodi 33100 në emër të transferit të kapitalit për entitete publike, për vitin 2018-26.500,00 euro, më 2017-11.000,0 euro dhe më 2016-40.750,00 euro, që janë më shumë mjete. Shuma e buxhetuar prej 3.096.852,41 euro është realizuar për 2.157,694 euro, apo rreth 70% e buxhetit. Shpenzimet për investime kapitale, për periudhlën raportuese, në krahasim me vitin paraprak, janë realizura për 12% më shumë se në vitin paraprak e ne nuk kemi kurrfar Listë se sa mjete janë realizuar nëpër fshatra, që mjetet nuk janë realizuar në tërësi e madje edhe ka borgje? Kërkojmë Listën e të gjitha fshatrave dhe të shohim se sa janë realizuar investimet kapitale nëpër fshatra, me emrin e projekteve të realizuar? Kështu, çdo fshat, do të informohej për realizimet nëpër fshatrave e veta. Po ashtu, kemi rënie të shkallës së grumbullimit të të hyrave vetanake, në emër të qirasë, për 10 mijë euro në vitin 2016, te liçencat ndërtimore kemi 18 mijë euro e tani vetëm 202,00 euro, kurse tatimi në pronë 24 mijë euro më i ulët e që, në vend që të kemi shtim në këtë kategori, ne kemi rënie të të hyrave? Po ashtu, është shqetësuese shuma prej 197 mijë eurove në emër të shpenzimeve të kontigjenteve e që për dy vite janë 440 mijë euro për shpenzime të kompenzimit të kontesteve gjyqësore. Edhe vitet e mëhershme kemi pasur shpenzime për kontestet e humbura gjyqësore, por jo me shuma, si kësaj radhe?! A keni ndërmarr diçka për zvogëlimin e shpenzimeve të këtilla dhe a jeni në dijeni se cila firmë punon në mënyrë jo korrekte?! Po ashtu, kemi gjendjen interesante lidhur me inkasimin e borgjeve të qytetarëve ndaj Komunës e që shuma është 1.838,30 euro, nga e cila 973 mijë në emër të tatimit në pronë, bizneseve 597 mijë euro dhe 271 mijë euro në emër të mos inkasimit të qirave, që do të thotë se persona të caktuar po shfrytëzojnë lokalet, pa qira, dhe nuk po i kryejnë obligimet ndaj Komunës dhe shtetit. Edhe në herë i kisha lutur organet komunale që të na dërgohet Lista e realizimit të investimeve kapitale nëpër fshatra, që secili fshat, si dhe Listën e shfrytëzuesëve individual të subvencioneve.

z.Naser Myrtezani- Unë do të fokusohem në atë që na keni dërguar me dokumentet zyrtare gjatë kësaj qeverisjeje të juaj 17-mujore dhe ne, si pasrti politike (LDK) dhe delegatë, nuk kemi parë se keni realizuar ndonjë projekt të madh në nivel komunal, pavarësisht nga ato shuma të hargjuara që i theksuat, z.kryetar, më herët me shifra dhe përqindje, pasi se gjendja në terren me projekte të pa përfunduara, si ujësjellësi qendror, as që i përmendët këto tema. Po ashtu, edhe rrugën "Zapluxhe-"Guri i Zi", që shpresoj të fillon këtë vit, edhe pse jemi skeptik, duke pasur parasysh parregullësit rreth tenderimeve që po bëhen në nivel komunal? Po ashtu, si delegatë dhe parti politike, kërkojmë që keqpërdorimet konkrete të mjeteve publike të ndërpriten, pasi se jemi në dijeni se ka keqpërdorime në kuadër të mjeteve për mallëra e shërbime, sidomos tek karburantet dhe ajo se drejtorët e shkollave po krijojnë fatura, duke i shfrytëzuar për dreka zyrtare dhe se ato po realizohen në Kosovë dhe jasht vendit, si në Shqipëri, ku po i hargjojnë mjetet e tilla?! Po ashtu, kemi informata se po blejnë edhe komplete rrobash, këpucë, kollare e që, në realitet, ato janë mjete të dedikuara për shpenzime të objekteve shkollore në emër të paisjeve për

mirëmbajtje të tyre e që, në rastin konkret, paraqet keqpërdorim parave publike?! Te karburantet, unë jam interesuar në shkollën time, si dhe në shkollat tjera, që sivjet nuk kemi pasur ndërprerje të shpeshta të rrymës, nuk ka pasur nevoja për shfrytëzim të generatorëve e mjetet s'ka pasur pse të hargjohen dhe, edhe po të janë hargjuar 10 litra, mos të tregohen si 100 litra të hargjuar, që kisha apeluar tek drejtorët të pengohen këto forma të hargjimit të parasë publike. Në bazë të bisedave me qytetarë, ata kanë shprehur gatishmerinë që të na paraqesin rastet e këtilla të keqpërdorimeve, që ne si delegatë e përfaqësues të popullit, që të paraqesim rastet e keqpërdorimeve nëpër secilën shkollë. Se di se sa kjo do të jetë e sukseshme, pasi se ne jemi përfaqësues të partive opozitare, por gjendja nëpër shkolla është e mjerueshme dhe me rënie të numrit të nxënësëve, siç kemi rastin mjerues e të rrezikshëm për mësim në shkollën e Xerrxes, apo edhe në atë të fshatit tim-Zaplluxhe. Po theksoj se shkolla në Xerrxe është e vetmja në Komunë që nuk e ka ndërtuar shteti, por është ndërtuar me iniciativën dhe kontributin e qytetarëve të sajë e që është rast për fillimin e punimeve në te. Edhe në shkollën e Pllajnikut, që nga viti 1980, nuk është investuar, kurse kur po vjen në pyetje tubimi i votave, gjatë zgjedhjeve, këtyre fshastrave po u kushtohet vemendje. Mjerisht, në asnjë shkollë tonën nuk kemi shenjëzimin e tyre me shenja adekuate e këtu në gjendje më të vështirë janë nxënësit e Buzezit që lëvizin përgjat rrugës së asfaltuar e nuk kanë siguri e që e kam theksuar edhe më herët dhe kërkoj që, për ata nxënës, të sigurohet në kombibus, për t'u transportuar në shkollën amë dhe se këta nxënës, vërtetë, janë në rrezik dhe hall edhe nga qentë endacak e që ne duhet t'u dalim në ndihmë?

z.Valon Shabani (drejtor i DEFinanca)- KyRaport i dërguar juve-delegatëve, është punuar nga Drejtorati ynë, kurse për MEFinanca kemi Raportin detal, me shifra treshifrore, por dhe ky Raport, që e kemi në shqyrtim, është i sakt dhe preciz. Te kategoria e pagave dhe shtesave, MEFinancave, në fund të vit, sukurse për të gjitha komunat, ka bërë redukimin e mjeteve në shumë prej 59 mijë euro, kurse shuma prej 1.009,00 euro është nga paga e fondit të donatorëve, sipas marrveshjes të cilën e kemi qysh nga viti 2012. Normalisht se kategoria e pagave e shtesave është më e madhe, karahsuar me vitiet e kaluara, duke e pasur parasysh shtimin e pagave, si dhe pagesën e stazhit të punës të punëtorëve të cilët kanë shkuar në pension. Sa u përket udhëtimeve dhe mëditjeve jasht vendit, do të filloj nga unë i cili kam qenë jasht vendit dhe kam marr mëditjet, që takojnë, si dhe kryetari 3 apo 4 herë në vizita zyrtare. Ka edhe vizita që organizohen nga OJQ-të, si në Shqipëri apo Maqedoni, pastaj mëditjet e delegatëve në vizitën studimore e që kanë marrë mëditje me shpenzimet e bëra, si dhe zyrtarët e ZLKKthimit që kanë qenë, disa herë, në udhëtime jasht vendit. Po theksoj se, për dallim nga komunat tjera, zyrtarët tonë dhe kryetari nuk i shfrytëzojnë disa mundësi, siç është avansi për udhëtime zyrtare jasht vendit. Ndërkaq, sa i përket kategorisë së transportit për nxënës, ky është Vendim që e ka miratuar Kuvendi e që është realizuar transporti për nxënësist: Rrenc-Dragash, Pllavë-Llopushnik, Xerrxe-Dragash, Kosavë-Pllajnik. Te shërbimet kontraktuese kemi një shumë të madhe, nga viti i kaluar, e që jeni njoftuar rregullisht e që kemi pasur pagesën e mësimdhënësëve që kanë shkuar në pensione e që u janë paguar nga 3 paga jubilarë. Po ashtu, kemi pasur edhe mjete të shpenzuara për emeregjenca, si psh.në f.Kuk, rrëshqitja e dheut në Restelicë dhe Brod, ujësjellësi në Brod e kaqalizimi në Breesanë, pagesa e një numri punëtorësh, për punës shtesë gjatë sezonit dimëror për pastrim të borës, shërbime teknike për rregullimin e nxemjes qendrore në shkollën fillore "Fetah Sylejmani", paisje e kabinetit të informatikës me tepison e paisje të mbeturinave, sanitarive e mirëmbajtje në gjimnazin "Ruzhdi Berisha" në Dragash. Te mobiljet, nën 1 mijë euro, fjala

është për tenderin i cili është hapur nga Komuna për furnizim të drejtorateve me mobilje, siç janë: ormanët metalik, karrikat e tavolinat etj. në bazë të kërkesave adekuate me materiale të tilla. Po ashtu, e kemi edhe Vendimin e mëhershëm të Kuvendit për furnizim me "lap-topa" të delegatëve, nga se materiali dërgohet edhe në mënyrë elektronike dhe seancat përcillen direkt edhe përmes MAPL-së e për këtë kemi edhe parashikimin me P/Vendimin për bartjene mjeteve, në pikën e 4-të seancës. Për kategorinë e subvencioneve, ato, me vendime përkatëse, publikohen në web-faqen e Komunës. Mjetete e transferit të kapitalit janë mjete të bashkëpunimit me ministritë kompetente apo organizata tjera, siç janë: UNDP-ja, Caritas-i, Helvetas-i etj. Sa u përket shpenzimeve kontigjente, theksoj se Komuna, vitin e kaluar, ka pasur obligime të pa paguara në shumë prej 250 mijë euro e që, këtë vit, ato mjete janë zvogëluar në 190 mijë euro, që paraqet progres dhe nuk kemi borgje, kurse vitj e klauar, kemi pasur edhe 3 mijë euro borgj në emër të përfituesëve individual. Edhe te vendimet gjyqësore kemi përmirësime, pasi se kemi vetëm pagesat për paga jubilarë, të një mësimdhënësi. Fondi nr.10 është hargjuar në lartësi prej 97%, që është pozitive, si dhe kemi kemi shtim të realizimit të investimeve kapitale, pos atim problemi kryesor lidhur me ujësjellësin qendror i cili, po të mos ishte, do të kishim realizim të investimeve kapitale të buxhetit me mbi 95%. Ndërkaq, mjete të pa realizuar vetanake kanë ngelur 400 mijë euro e që janë të përcjellura edhe nga vitet mëhershme e që i përcjllim për realizim të projekteve. I kemi marr edhe disa projekte të ministrive në emër të bashkëpunimit me donatorë, si rregullimi i shtratit të lumit në Bresanë-55 mijë euro, hapja e rrugës Brod-Zlipotok po ashtu me 55 mijë euro, në bashkëpunim me MZHRajonal, rinovimi sallës në Shtëpinë e Kulturës në Dragash me 68 mijë euro, përmes MAPL-së, pastaj rrugët Xerrxe-Pllajnik me 366 mijë euro, Brezne-Trokan me 190 mijë euro, Zlipotok-Brod me 54 mijë euro, deponia me 16 mijë euro, si dhe rinovimi i kësaj salle të Kuvendit me 70 mijë euro. Disa nga këto projekte janë disa vjeçar, që do të thotë se, nëse nuk kanë përfunduar, do të vazhdojnë viteve vijuese, si projekte disa vjeçare.

z.Laurat Krasniqi- Dëgjova nga kolegët e mijë se paskan marr mëditje e çfar lëvërdie kanë qytetarët nga ato udhëtime? Kanë shkuar në det e kanë marr mëditje, e që është jo logjike dhe t'u shkon për nder. Sa i përket buxhetit, realisht, ka përmirësime sa i përket realizimit, por sa u përket realizimit të projekteve ka mangësi, si dhe kemi shtim të shpenzimeve për për mallëra e shërbime e aty shifen mëditjet, karburantet etj. Kjo nuk është diçka që kemi të blëjm me punë për të mirën e qytetarëve. Po i shof këtu të LDK-së se po derdhin "lotë krokodili", reth "lap-topave", e që janë "brum" i njej si PDK-ja, pasi se, një herë, i kanë marr ata, e a nuk qenkan rehatuar dhe, më vjen keqë, por nuk ka pasur nevojë për "lap-topa" tjer e që, pas çdo ndërrimi të përbërjes së Kuvendit, të blihen të tjerë?!

z.Naser Myrtezani- Pasi se u përmendëm nga kolegu parafolës i VV-së, e që shpresoj të jetë hera e fundit që e përmend LDK-në në kuadër të keqpërdorimeve, nga se nuk është hera e parë se vepron ashtu, nga se ne nuk jemi në pushtet në 3 mandatet e fundit dhe, kur flet reth mëditjeve, duhet të theksoni se kush dhe për çka, pasi se ti je ai prodhim i njejt i cili e ka votuar këtë parti politike në pushtet (PDK-në) e cila po qeverisë e që u ke ndihëmuar ti, që të janë aty e sot e tani po e kritikon LDK-në, që pra mos të kesh asnjë vërejtje për LDK-në?! Pra, nuk dua që, edhe një herë, të përmendni LDK-në, në kuptim të keqpërdorimeve dhe, nëse diku sh nga LDK-kja, ka bërë diçka, dilni dhe thuane konkretisht. Unë jam nënkryetar i LDK-së dhe asgjë nga pushteti nuk kam përfituar dhe, këtë që po e theksoni, janë trillime e gënjeshtra. Të gjithë të kanë kuptuar se kush je dhe çka je, me trillime dhe me insinuata e rrena ndaj të tjerëve, nuk fitohet pushteti, por me punë dhe argumente. Ne, si LDK, këtu përfaqësojmë 5200 vota, e

unë personalisht 260 vota të miat e ku janë votat tuaja, për të cilat po del dhe po flet, e ato që i ke fituar i ke që ke qenë bartës i Listës dhe, po të ishte edhe nëna ime në bartëse e Listës, sot do të ishte delegatë! Pra, kjo le të jetë vërejtja e qarë dhe fundit, që flisni për LDK-në?!

z.Sefidin Mevizini- Sa u përket "lap*-topave", kryesuesi kishte të drejtë, pasi se, ne LDK-ja, se kishim ndërmend, por ti ishe ai që kërkoi "lap-topa" e tani po merr të drejtën të flasish, për ata, e nuk ke të drejtën, por vetëm po dëshiron të implikohesh me LDK-në?! Por, e ne jemi shumë më të mëdhenjë se ti-ju (L.K. "VV"), e këtë po t'a them personalisht, pasi se t'y nuk të takon të merresh, me këta të PDK-së e lere me ne të LDK-së, pasi se partia e jote, e plotë të atillë, që i kanë librezat e PDK-së, pra edhe ju, jeni të atillë?!

z.Samidin Xheladini- Dikush po e shfrytëzon këtë vend për të t'u promovuar përmes "Facebook-ut" dhe, më vjen shumë keqë, për performancat e KDI-në, për të cilët kisha i lutuer që të jepni performancën e secilit delegatë dhe unë me vemendje e dëgjova diskutimin e juaj, apo postimet përmes internetit dhe kërkoj që të vazhdon, si KDI, me punën tuaj dhe, për secilin delegatë, të jepni performancën. Ju, peronalisht (L.K.), lidhur me këtë, keni thënë dhe shkruar se, një delegat i Kuvendit, po del 2 minuata në foltore e këtë po e shfrytëzon për të promovuar vehten, por për të manipuluar me njerëz, mund të them se ky është obligimi ynë, nga se, për këtë, marrim paga dhe gjithë kjo në emër të qytetarëve, nga se dijmë se jemi shtet demokratik dhe se komunizmi moti ka përfunduar. Sot e kemi demokracinë dhe kemi të drejtën të japim sugjerime, vërtetje e propozime, për të mirën e qytetarëve. Këto gjëra nuk duhet t'i marrim personalisht, por që këtë, dikush, po e promovon vetëvehten! Unë, kam thënë disa herë, se vendimet e Kuvendit janë obligative dhe unë nuk kërkoj përgjigje e jo nga dikush-si ju, që nuk ka të drejtën e dhënies së përgjigjes?! Ndoshta, edhe unë mund të votoj "kundër" ndonjë vendimi të caktuar Kuvendit, por nëse Kuvendi miraton Vendimin, unë atë e kuptoj si Vendim obligativ të cilin duhet t'a respektoj. Ai i cili nuk i respekton vendimet e këtij Kuvendi dhe këtë shtet, atëherë është kundër këtij shteti?! Ne jemi kundërshtarët më të mëdhenjë të pozitës, por jemi njerëz të shtetit dhe e përkrahim atë. Pra, mos na shitni "fore" se gjoja jeni për shtet e, në realitet, punoni kundër tij dhe kjo, vërtetë, të jetë hera e fundit që flisni për partinë tonë politike dhe sajoni të pavërteta për ne. Unë desha të parashtroj pyetje lidhur me mos inkasimin e mjeteve vetanake, në shumë prej 1.8 milionë euro, dhe nuk e kam marr përgjigjen në zyrën e Tatimit në Pronë e për kompjuterët("lap-top") dëgjuam se ata na nevoiten dhe se, pa ta, nuk mund të punojmë. Për ujësjellësin qendror, ne si Kuvend, kemi shprehur gatishmërinë që të japim përkrahjen, shpenzimet kontigjente, nga viti në vit, po na kushtojnë shtrenjë e me miliona euro dhe mos të jeni ju ai i cili do të jetë në shënjestër për këto shpenzime, por të jep përgjigje ai i cili nuk po i kryen punët si firmat e caktuara gjatë realizimit të të projekteve dhe projektet e tillë mos të pranohen? Unë e di se nuk ka keqpërdorim të mjeteve, por nuk është keqë që të ofrohet Lista e përfituesëve të subvencioneve e po ashtu edhe Lista e investimeve kapitale, që të dihet se sa, në secilin fshat, është investuar e punuar. Lidhur me stadiumin, nuk mora përgjigje? Borgje nuk kemi e obligime kemi e çka është realiteti? Ajo që brengoj sanë mjetet e donatorëve dhe, vërtetë, nuk mund t'i përfitojmë nga ato, nëse sillemi kështu, siç po debatojmë edhe sot, pasi se donatorët, kur të shofin se te ne ka probleme serioze, ata do të krijojnë përshtypjen se s'ka seriozitet dhe ka trillime e gënjeshtër e ta kështu do të na anashkalojnë e largohen nga ne.

z.Shpetim Hajredini- Lidhur me Raportin, që e kemi nga DEFinanca, si dokument, është shumë i mirë dhe i saktë e me informata të nevojshme. Ne të gjithë, pajtohemi se duhet zvogëluar shpenzimet vetanake, por duhet zvogëluar aty ku, vërtetë, ka nevoja e mundësi. Ndoshta, ka mundësi, që Raporti të jetë edhe më i mirë, por ai i plotëson standardet dhe, kur janë në pyetje të hyrat vetanake, shënimet jana reale dhe e gjithë ajo që ka ngjarë me financat, gjatë vitit 2018. Kemi shpenzimet e udhëtimit e e dijmë se, në vitin 2017 kemi pasur shpenzime 7 mijë euro e në atë 2018- 6 mijë euro, që do të thotë se ato janë më të vogëla se më parë. Unë mendoj se, ndonjëherë, shpenzimet janë të nevojshme dhe se ato duhet bërë aty ku duhet shtuar shpenzimet, se psh.te shëndetësia kemi 12 mijë euro, në vitin 2017 e, në vitin 2018 kemi 92 mijë euro, që mendoj se materiali që po e debatojmë është komplet. Dikush e përmendi përzierjen e brumit, në mes të PDK-së tani dhe më herët e, ndoshta, edhe unë jam në këtë brum, por i kam 32 vjet dhe askuj nuk i kam bërë asnjë të keqe e as që mendoj për ate. Tani i kam fituar votat e qytetarëve dhe këtu, jam i barabartë, me ju dhe mundohen, për të mirën e këtij vendi. U përmendën mëditjet, edhe pse as që e di se a janë paguar ato dhe, personi që e ngriti çështjen (L.K.), po e shfrytëzon "facebookun" me fjali për të na zhvleftësuar si persona para popullit, edhe pse mëditjet janë çështje që parashinen ligjërisht.

z.Sefidin Mejzini- Ne jemi të paguar për punën tonë dhe ditën e sotme dhe, nëse duhet, do të qëndrojmë tërë ditën? Lidhur me "brumin" e përmendur pot heksoj se nuk jemi jashtëtokësor që nuk dijmë e dikush të të mëson, pasi se ai (L.K.) ishte i pari që kërkoi "lap-topa" (Kryesuesi B.M.- Po, e vërtetë dhe ai ka thënë se do t'i fal një studenti?!) dhe, vërtetë, të gjithë jemi të njejtë, por dikush më shumë e dikush më pak?!

z.Zaim Hajredini- Është fakt se është bërë rutiniore dalja në foltore, pasi se po e fillojmë, me pikën e parë, e përfundimi askund?! Kjo të jetë vërtjtje serioze për kryesuesin e Kuvendit, pasi se seancat po na zgjaten, me orë të tëra, sepse po diskutojmë për çështjet që nuk i kemi votuar, me rend dite, duke dal jasht atyre pikave e, për këtë, keni të drejtën të ndërpritni delegatët që dalin nga rendi i ditës. Ndërkaq, në anët tjetër, kemi pikën e zakonshe-"eventuale" ku mund të diskutojmë për çështje të ndryshme të paqarta, e për të cilat dëshirojmë të hapim tema. Foltorja mos të shfrytëzohet që diskush të kritikohet e dikush të akuzohet, siç kishim rastim më parë, dhe përshëndes z.Samidin Xh. që iu përmbajt rendit të ditës e që pastaj, i provokuar nga kolegu (L.K.), doli jasht rendit të ditës. Prandaj, nëse vazhdojmë kështu, unë lirisht, po mundi të dal në foltore dhe të parashtrajnë çështje, për të cilat edhe 50 minuta do t'i kisha pak?! Propozoj, që t'i përmbahemi rendit të ditës dhe t'a respektojmë njëri-tjetrin, e për ata që ofendojnë, ekzistojnë mënyra për të vepruar. Gjithashtu, propozoj që, në të ardhmen, të na dërgohet Lista, në excel, e projekteve të investimeve kapitale, që të shifet se sa janë realizuar projektet te ne?

z.Rexhep Kamberi- Dua të lëvëderoj Raportin Vjetor Financiar/2018 dhe të përshëndes drejtorin e DEFinanca i cili, decitivisht e në mënyrë precize, e ka përfshirë hargjimin e mjeteve të shpenzuara. Unë, u paraqita për nevojën e shtimit të të hyrave vetanake të Komunës, pasi se dje në KKomunitete u njoftuam se 80% e pronës së Komunës është e pamundur të shfrytëzohet, pasi se është në kontekst me AKPronës. Dua të pyes kryetarin, dhe të shfrytëzoj prezencën e KDI-së, që të intersohen se në cilën fazë është zgjidhja e kontestit të Komunës me AKP-në, pasi se ai kontest mund të zgjasë pafundësisht-10 e

mës shumë vite e Komuna jonë po ngel pa grumbullim të të ardhurave dhe nuk po disponon me pronën e sajë?!

z.Hajrudin Hoxha- Pasi se sot po e diskutojm këtë Raport Financiar/2018, dëshiroj të pyes reth shpenzimeve, e që shumë çka sqaroi drejtori, e ajo që do të pyes ka të bëj lidhur me sigurimin e lëndëve djegëse nëpër institucione, pasi se vjet ka ngjarë që ato të sillen natën-në ora 11,00, që do të apeloja në ZProkurimit dhe të tjerët, që të janë azhur, se këtu janë në pyetje lëndët djegëse nëpër institucione, sepse vjet ka ngjarë qëa to të sillen natën-në ora 11,00, që do të apeloja, në ZProkurimit dhe të tjerët ,që të janë azhur, se kur janë në pyetje shkollat apo ambulancat, të janë prezent, pasi se në orët e vona furnizimi është shumë i dyshimt, nga se shifet se, buxheti për sigurimin e tyre, parashihet të shtohet nga 50 në 70 mijë euro e ne, nëpër ambulanca apo shkollat tona, po ngrohemi me nxemëse. Ndërkaq, sa u përket investimeve kapitale në Restelicë ato të realizohen, ndërsa ekziston problemi i urës së pa përfunduar Krushevë-Resticë e që ka nevojë të intervenohet, dhe se s' di se si ka mundur të pranohet, si i tillë?!

Kryetari- Çdo diskutim i juaji është i mirëseardhur për ekzekutivin e Komunës dhe, është normale se, kur debatohet për Raportin e shpenzimeve buxhetore, ekziston interesimi për mënyrën e shpenzimeve të bëra, për periudhën raportuese. z.Naser M. pyeti për reth investimeve kapitale, që mund të them se nuk janë realizuar, vetëm 2 projekte, nga Lista e investimeve të tilla dhe atë ujësjellësi qendror dhe zgjerimi i rrugës Leshtan-Radeshë dhe, po mos të ishte çështja e ujësjellësit qendror, do të ishim komunë me 95% të realizimit të investimeve, nga të hyrat vetanake. Lidhur me këtë Projekt të ujësjellësit, lënda lështë në AKKorrupsionit, dhe presim përfundim të rastit, me fillim të realizimit të Projektit. Ndërkaq, lidhur me këtë gjendje të krijuer me Projektin, unë jam në gjendje të ftoj të gjitha mediat dhe palët e interesuara që të vijnë në hapjen e këtij tenderi, për të parë se gabimet nuk janë te ne dhe se jemi të interesuar për realizimin e këtij Projekti tejet të rëndësushëm për ne. Po theksoj se këtu nuk ka asgjë politike, pasi se nuk është normale që, në rrëzë të "Maleve të Sharrit" e mos të kanë ujë të pijes 15 fshatra të Komunës son?! Sa i përket rrugës për "Gurin e Zi", ai është Projekt i cili duhet të përfundon këtë vit dhe, sipas operatorit ekonomik, kemi mjete të mjaftueshme për përfundim e tij. Meqenëse një pjesë dërmuese e delegatëve i takojnë lëmisë së arsimit, ju kisha lutur se, nëse keni argumente, për çdo formë të keqpërdorimit, të paraqë publike në arsim apo sektor tjer, këto konstatime mos të ngelin vetëm fjalë dhe, po ashtu, ju kisha lutur, që për këtë të jeni të përgjegjshëm dhe të zbulohen gjërat deri në fund e me argumente-pavarësisht nga përkatësia politike, sepse paraja publike është para e qytetarëve tonë. Për shkollën e Xerrxes, jemi në dijeni se ka nevojë për riparime dhe, sa u përket mjeteve, do të analizohet gjendja, se çka mund të bëjmë, gjatë këtij viti? E njejtja gjë vlen edhe për vendosjen e shenjave të trafikut para shkollave tona, kurse sa i përket transportit të nxënësëve, gjendja është pak sa më e komplikar, sepse, shumëçka, varet nga numri i nxënësëve dhe specifikat e fshatrave, por do të analizohet situata. Lidhur me shpenzimet për mëditje, ato oparashihen e këtu bën pjesë edhe Plani i Kuvendit ku parashihet, çdo vit, vizita studimore e delegatëve e që e praktikojnë edhe komunat tjera dhe, natyrisht, në baza ligjore, u takojnë edhe mëditjet adekuate për udhëtime. U përmendën edhe sigurimi i "lap-topave" dhe z.Samidin Xh. theksoi se, çdo vendim i Kuvendit duhet të realizohet dhe është fuqiplotë nëse është votuar, që pajtohem edhe unë se duhet të pajtohen edhe ata që kanë qenë kundër e që nuk kanë qenë shumicë e votimit. Për këta kompjuter, MEFinancave ka konstatuar se ata duhet të sigurohen nga kategoria e investimeve kapitale e jo nga mallërat e shërbimet, për shkak të shumës që nevojitet, e për këtë ende nuk

është realizuar ai Vendim. Është e vërtetë se, një sasi e mjeteve tona shkon në suficit, por kjo nuk do të thotë se ato nuk do të shfrytëzohen, pasi se i këthehen shtetit dhe neve. U përmend edhe realizimi i pamjaftueshëm i mjeteve vetanake, por po theksoj se ato mund të përcillen e shfrytëzohen në vitin vijues. Ka pasur raste të komplikuar se, më herët, prona shoqërore është dhënë në shfrytëzim e që pastaj aty janë ndërtuar edhe shtëpi e që tani vështirë po mund të gjejmë zgjidhje, se si të rikthehet ajo pronë? Për këtë, mendoj se bizneset duhet të kanë qasje tjetër për pronën dhe të respektojnë bazën e procedurave ligjore, pasi se në funksion të përkrahjes së bizneseve kemi haraturar edhe Rregulloren ku partashihen lehtësim për t'u marr me biznes, por që duhet kompenzuar obligimet e mëhershme. Në anën tjetër, sa i përket pyetjes, reth furnizimit me lëndë djegëse, sidomos nëpër shkolla, mendoj se, sivjet, do të veprohet më ndryshe dhe me seriozitet më të madhe dhe se procedurat do të përfundojnë, deri në shtator.

Kryesuesi- Në rregull, nëse nuk ka edhe diçka, Raportin e qesim në votim dhe kush është "për"-16, "kundër"-6 dhe 0 vota "të përmbajtura", që konstatoj se e miratuar Raportin Vjetor Financiar/2018.

Pika e III-të (tretë) e rendit të ditës

Kryesuesi- Vazhdojmë me punën dhe, në kuadër të kësaj pike të III-të kemi shqyrtimin dhe miratimin e Planit për Veprimet Transparent në Komunën e Dragashit, për periudhën e viteve 2019-2023, të haruar sipas rekomandimeve të MAPL-së, për periudhë 4-vjeçare e jo si më parë, për periudhë 1-vjeçare, hapim dsiksutimet...?

z.Samidin Xheladini- Pas Raportit Vjetor Financiar, tani e kemi Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën tonë, për çka edhe duhet të miratojmë Vendimin. Siç keni vërejtur në material, janë paraparë edhe qëllimet që duhet të realizohen me aktivitetet që duhet ndërmarr - sipas Planit, si dhe afatet e parapaar ligjore. Ky Plan, gjithashtu, parashef edhe qasjen në dokumente zyrtare, si dhe publikimin e tyre në web-faqen e Komunës. Po ashtu, përmendet pjesëmarrja transparente e e qytetarëve në institucione komunale, si dhe në tenderime e furnizime e punësime transparente etj. Në fund, mendoj se e gjithë kjo, do të ngel fontanë dëshirash e jo se diçka do të realizohet? Ne dëshirojmë të besojmë në këto premtime, por psh.punësimi, vërtetë, zhvillohet në baza politike, pavarësisht nga përgatitja profesionale e kandidatëve, duke u punësuar personat që kanë lidhje familjare e politike me njerëzit në pushtet. Kjo, vërtetë, është mjeruese dhe diskriminuese dhe, siç dihet, kur në të gjithë vendet e botës po kërkojnë punësime e fuqi punëtore, në mungesë të sajë, te ne po ngjanë e kundërta se kemi mjaft fuqi punëtore e nuk po mund t'u sigurojmë vende pune. KDI-ja, vazhdimisht, e përciell punën tonë dhe jep vlerësime lidhur me transparencën, sipas indikatorëve. Në bazë të sugjerimeve të dhëna nga ky Institut, Komuna jonë nuk ka rregullore reth publikimeve, Zyra e Kryetarit ka mjaft dobësi dhe vërejtjet më të mëdha janë adresuar në lëmin e financave, ku Komuna nuk është sa duhet transparente, si dhe qytetarët nuk kanë njohuri lidhur me vendosjet përmes KPFinanca, përfshi këtu edhe vetë informimin e Kuvendit? Rekomandimet që janë dhënë, ndoshta, i keni lexuar, e që kryetari është njoftuar edhe zyrtarisht, kanë të bëjnë me këtë: harimin e rregulloreve, publikimi i kontakteve të zhvilluara lidhur me gjendjen në QKMF, ambulanca etj., publikimi i Planit të Punës së Kuvendit, angazhimin e zyrtarit për informim, përcjellja e ankesave nga një Komision apo Këshill, të kemi Rregullore për Dhunën Familjare e Seksuale, të respektohet barazia gjuhësore në komunë, të bëhen informimet përmes Web-faqes e rrjeteve sociale, të

publikohet Lista e investimeve kapitale nëpër fshatra, të zyrtarizohet zgjedhje e udhëheqësive të fshatrave, të funksionon një lidhje e hapët telefonike e kontakteve me qytetarë - pa pagesë, për dhe me qytetarë. Në këtë konteskt, shfyrhtëzohet rastin t'i falenderohem z.Elmedina Baxhaku nga KDI-ja për kontributin reth demokartizimit të mëtejshëm të organeve tona komuanle, të cilat po përcillen.

z.Nexhat Isufi- Kur flasim për transparencën duhet të jemi të vetëdijshëm për ato lëshime që bëhen ndaj transparencës, por që, në radhë të parë, do të theksoja që të jemi vetëkritikë dhe të fillojmë transparencën nga vetë ne, e sidomos kur janë në pyetje takimet publike me qytetarë që mbahen çdo 6 muaj e pjesëmarrja jonë në to është shumë e vogël! Për këtë, ne jemi të obliguar që të jemi prezent dhe të dëgjojmë kërkesat dhe vërjetjet e qytetarëve. Rekomandimet që ka dhënë KDI-ja i kontribuojmë transparencës e Komunës sonë i mungon zyrtari për informim dhe zëdhënësi me person të përgatitur profesionalisht për t'u njoftuar për punën e institucioneve komuanle? Ky domument, nëse e shikojmë si të tillë, është mjaft i mirë, por duhet vepruar sipas tij e, nëse punojmë ashtu, nuk do të kemi nevojë të flasim për transparencën, që me veprime të jemi në funksion të shtimit të saj, siç po veprohet nëpër komunat tjera, në nivel të shtetit tonë.

z.Munir Jonuzi- Ky Plan i Transparencës është i mirë dhe subjekti im politikë (Vakat-i) do t'a përkrahim dhe votojmë. Por, do të theksoja disa pjesë të tij, si në pikën 1 ku theksohet se lajmërimet për seancat e rregullta duhet të janë publike 7 ditë pune e jo, siç qëndron - 7 ditë e për të jashtëzakonëshme 3 ditë pune, para mbajtjes së tyre, apo mos është fjala për "gabim teknikë"? Kjo që po theksoj është në harmoni me Ligjin për Vetëqverisje Lokale, Statutin dhe dokumentet tjera lidhur me transparencën. Po ashtu, po rikujtoj se, në njerën nga seancat e mëparshme, kur e kemi miratuar Planin e mëhershëm, kam përmendur mungesën e gjuhës boshnjake në web-faqen e Komunës. Për këtë, po shprehi mirënjohje se ekzekutivi dhe shërbyesi i TI e ka përmirësuar këtë dhe tani e kemi edhe kategorinë e gjuhës boshnjake bashkarisht me atë serbe, ku figuron si srb.-bos. Kjo paraqet hap pozitiv e ne duhet të punojmë ende lidhur me transparencën në Komunën tonë. Sa i përket web-faqes, mendoj se duhet funksionalizuar edhe 2 kategori me publikimin e nënkategorive për KPFinanca dhe KKomunitete, ku do të publikoheshin ftesat, procesverbalet e dokumentet tjera të këtyre komiteteve obligative. Këtë po e theksoj nga fakti se, në takimet që kanë qenë të organizuara nga Asociacioni i Komunave të Kosovës etj., ngjante që të konstatohej se "pos në komunat serbe, më pak informata kemi nga Komuna e Dragashit", që janë humbur disa projekte, pikërisht, për shkak të transparencës?! Për dallim nga vitet emëhershme, kemi qenë në përmirësim e që llogaris të vazhdohet edhe në vitet vijuese.

z.Zinaida Elmazi- Pasi po flasim për transparencën, më vjen keqë që nuk janë koleget tona nga komuniteti shumicë dhe më pengon mënyra e këtill e sjelljes e do të vem në pikpyetje edhe votimin, por ndoshta, kanë pasur arsye?! Këtu po e ndërliidhi sjelljen e pahijshme dhe punën e ZÇGjinore e cila na dërgon ftesa dhe emaila, vetëm në gjuhën shipe, edhe pse nuk kam kundër, por duhet të respektohem edhe ne në gjuhën tjetër, që pra kërkoj barazi në trajtim gjuhësor dhe pjesëmarrje në takime?! Lidhur me funksionin e transparencës, po theksoj se vitin e kaluar, nga Komuna jonë, për RTK-2 është siguruar një kamerë për programin "Svetlost Gore", kërkoj që të bëhet informimi i drejtë për komunitetin Goranë, por edhe Boshnjak-që unë nuk po kontaktohem nga ai emision e ne delegatët, si përfaqësues të popullit, duhet të japim vlerësim e deklarata në emër të komunitetit Boshnjak, që e përfaqësojmë? Për këtë, duhet

të kërkohet prezenca e tyre, për të xhiruar e informuar edhe për takimet tona, përfshi edhe seancat tona. Për gjendjen në Komunën tonë, treva e Gorës po ngel jasht ngjarjeve dhe e pa informuar, pasi se, siç dihet, "Radio Gora" nuk është duke funksionuar, pas djegies së lokaleve të saj e që nuk u informuam, zyrtarisht, për rethanat e zjarrit që ka ndodhur?! Për këtë, kërkohet nga kryetari, që fton atë OJQ të cilës ia është ndar kamera dhe RTK-në, që të dihet destinimi i qartë i rolit të asaj kamere, që të përcillen drejtë ngjarjet te ne, në kuadër të shemës programore të RTK-së.

z.Zaim Hajredini- Kur flasim për transparencën, kjo është çështje e rëndësishme për shtetin dhe demokracinë dhe unë e përkrahi këtë Plan Afatgjatë të Transparencës, ndërsa nga viti i kaluar, ka përmirësim të dukshëm të transparencës te ne. Për këtë, ndoshta, nuk jemi 100% transparent, por ka përmirësime të dukshme pozitive, për shumë indikatorë. Një fakt i këtill është përmirësimi i funksionimit të web-faqes, me ngjarje e dokumente më shumë se sa më herët, e që më vjen mirë se, edhe delegatët, po angazhohen për transparencë, që të jemi komunë sa më transparente, që në vitet në vazhdim, mos të kemi vërejtje nga ata që e përcjellin punën tonë, sidomos ato rekomandime që bëhen nga Auditori Gjeneral. Për këtë, mendoj se të gjitha organet komunale duhet të angazhohen dhe bashkëpunojnë me me, sidomos lidhur me ndihëmesën tonë në zgjedhjen dhe konstituimin e udhëheqësive të fshatrave tona, që të bëjmë komunën tonë sa më transparente, që pra e përkrahi Planin e këtill, përfshi këtu edhe vërejtjet dhe rekomadimet të cilat dolën nga seanca, për verzionin zyrtar të Planit.

z.Rexhep Kamberi- Unë do të lëvdëroj këtë Plan dhe paraqitja ime këtu ka për qëllim lëvdrimin e transparencës së përmirësuar, gjatë mandatit tonë. Këtë e arsyejon vetë fakti se seancat tona përcillet e trasmetohen përmes You Tubes apo "Radio Sharrit" e kjo e dëshmon transparencën e Kuvendit dhe Komunës, në tërësi. Këtu i radhis edhe raportimet e drejtorit të DEFinanca, që kanë qenë transparente, nga ss kemi marr përgjigje të duhura e të argumentura për çështjet që kemi kërkuar. Do të ndërlidhem në diskutimin e z.Zinaida E. dhe thksoj se unë, vërtetë, nuk kam detaje lidhur me atë kamerë për RTK-në 2, por e di se ata janë të obliguar të informojnë për ngjarjet te ne, edhe pse s'i dijmë obligimet e parapara me Kontratë? Në këtë kontekst, unë po theksoj se emisioni "Svetlost Gore" i RTK-së 2 neve, vazhdimisht, na kontakton, duke na pyetur për aktivitete e planet, që theksoj se ne, përfaqësuesit e komunitetit Goranë, kemi kontakte korrekte me bashkëpunëtorin e këtij emisioni, edhe pse nuk mund të jap vlerësime për kondrsharët tjerë politikë, që mund të kanë mendim tjerë?!

z.Zinaida Elmazi- Lajmërohem për replikë dhe z.R.K. po theksoj se unë, si përfaqësuese e partisë time Boshnkakle (Vakat-it) , me Statutin e partisë, e përfaqësoj komunitetin Boshnjak dhe Goranë dhe, nëse e kemi përkrah ndonjë OJQ, ajo duhet të jetë korrekte dhe të veron pa diskriminime, pavarësisht se a është në pyetje GIG-u, Vakat-i apo PDK-ja e LDK-ja dhe se, ai emision, është për mbar territorin tonë, sepse, kur bëhet fjalë për tema të ndieshme e madje edhe vendosjen e revoles në ball, unë duhet të dal në opinion e po bëhen anashkalime të rasteve?! Pra, meqenëse Komuna jonë e ka finansuar atë kamerë, kryetari duhet të bënë Marrveshje për përcjelljen e ngjarjeve në mënyrë korrekte e të gjithanshme, përfshi edhe punën e Kuvendit tonë dhe unë nuk e përkrahi këtë formë të informimit nga ky Emision i RTK-së 2.

z.Rexhep Kamberi- Të jemi të qartë se këtu nuk bëhet fjalë për OJQ-në, e cila e ka marr projektin e tillë, pasi se emisioni "Svetlost Gore" punon sipas shemës programore të RTK-së e jo për OJQ-në?!

z.Zinaida Elmazi- Ne i kemi rendet e ditës së seancave, që publikohen me kohë, dhe kanë mundur të përcillen nga ky Emission i RTK-së 2 e që kanë mundur të përcjellin punën tonë edhe rreth çështjeve të ngritura rreth mini-hidrocentraleve dhe, mos merrni guxim që të mbron dikend, pasi se ne i kemi përkrahur e ata kanë obligim të përcjellin punën tonë.

z.Velid Haxhisin- Lidhur me këtë temë rreth transparencës, unë do të përmendja faqen "facebook" të Komunës e që kjo faqe është shëndërruar në mjet kryesor komunikimi, që nga kryetari e deri te organet lokale, që nuk është kontestuese që kryetari i Komunës të ketë faqe të tillë, ku paraqiten të reja e shënime për t'u informuar opinioni apo drejtorët, por që kontestuese është se informimi po del të bëhet vetëm në një gjuhë. Mendoj se kjo nuk është në rregull dhe nuk është në funksion të transparencës në Komunën tonë, pasi se qytetarët kanë të drejtën të informohen në dy gjuhë zyrtare, sipas ligjeve. Për këtë, kemi informata se ajo faqe po mbahet në mënyrë vullnetare, por që, edhe nga ana e jonë do të kishte përkëthyes vullnetarë, që e gjithë kjo të jetë në funksion të informimit për ngjarjet te ne. Po shfrytëzoj rastin të theksoj se transparencë do të thotë kjarhtësi e te ne disa gjëra nuk janë të kjarra e të qarta sa që nuk mund të flasim për transparencën?

z.Laurat Krasniqi- Dua të ndërlihem në diskutimet e delegatëve e komunitetit jo shumicë, të cilët folën për kamerat dhe përcjelljes së Kuvendit tonë e që po them se, në këtë aspekt, ne si komunitet shumicë, jemi të diskriminuar. Me sa jam unë në dijeni, Kuvendi Komunal as që ka qenë e njoftuar kur ka qenë në pyetje kamera e tillë, por që ajo është ndar sipas një Memorandumi në mes të ish-kryetarit të Komunës dhe RTK-së. Tani po kemi diskutime të koleges sonë (Z.E.) se Kuvendi paska dhënë Pëlqimin për sigurimin e asaj kamere dhe se ajo qenka ndar për t'u përcjell aktiviteti i Kuvendit dhe i komunës në përgjithësi dhe, realisht, ata të RTK-së duhet të marrin pjesë në takimet tona. Sa i përket web-faqes së Komunës, ka përmirësime të dukshme, por është çështje se ende ka hapësirë që ajo të jetë edhe më e mirë e përmirësore. Ndërkaq, sa i përket konkurseve, mund të them se, paraparakisht, dihet se kush do të pranohet në punë, si dhe mendoj se kolegu parafolës gaboi kur theksoi se, ata që e mirëmbajnë web-faqen apo "facebookun" e bëjnë vullnetarisht, që mendoj se kjo nuk është e vërtetë, por se ata paguhen mjaft mirë?!

Kryetari- Siç e dini, Plani për Transparencë është miratuar, për çdo vit, por që tani kemi rekomandimin e ri të MAPL-së që ai të jetë i miratuar për periudhë 4-vjeçare. Nëse e shiqojmë Planin e këtill, mund të konstatojmë se ai është tejet ambicioz dhe pajtohem me delegatët që të jepen edhe sugjerime të caktuara. Ne, në ndërkohë, kemi punuar rreth përmirësimit të transparencës në Komunë. Lidhur me atë që theksoi z.Samidin Xh. rreth konstatimeve të KDI-së, çdo fakt i theksuar është i pranueshëm, si bazë për përmirësim të gjendjes në ato segmente ku ka lëshime e gabime eventuale. Në disa gjëra, ndoshta, kemi qenë më të mirë se sa që e përmendi kolegu. Një fakt i tillë është me publikimin e Raportit të Kryetarit dhe planeve të punës së drejtorateve dhe vetë Kuvendit Komunal, të cilët janë të publikuar në web-faqen e Komunës. Në anën tjetër, dua të them se kemi edhe probleme tjerë se, një numër i madh i qytetarëve tonë, nuk kanë qasje në internet dhe se nuk po mund t'i shfrytëzojnë

mundësitë që ofron teknologjia informative, sepse aplikacionet në web-faqe lehtësojnë procesin administrativ. Keni të drejtë kur theksoni se Komuna duhet të ketë zyrtarin për informim apo zëdhënësin e ai pozicion, me autorizimin tim, aktualisht, kryhet nga drejtori i DAPersonelit, si dhe pajtohem me z. Munir J. i cili theksoi se disa fakte duhet ndryshuar e plotësuar. E vërtetë është edhe ajo se Komuna e ka web-faqen dhe "facebookun", ku publikohen gjëra që ndodhin e që mirëmbahen e menaxhohen vullnetarisht dhe se do të tentojmë, në bazë të sugjerimeve tuaja, të gjejmë mundësi që edhe përkthihem të jenë në gjuhët e duhura në web-faqe. Sa i përket kamerës apo kanalit televiziv, që mund të përcjellin takimet tona, po theksoj se takimet tona janë të hapta për opinion dhe se asnjë shtëpi televizive nuk ka ndonjë kontratë për përcjelljen e takimeve tona, në bazë të të cilës do të paguhej. Dhënie e Pëlqimit për sigurimin e TV kamerës ka qenë masë me qëllim të mirë afirmativ të komuniteteve të ne e që është çështje e cila ka ndodhur në mandatin e mëhershëm të ish-kryetarit të Komunës.

Kryesuesi- Kalojmë në votim dhe kush është "për"-14, "kundër"-1 dhe 0 vota "abstenim", që konstatoj se miratum Planin për Transparencë në Komunën e Dragashit për periudhën 4-vjeçare/2019-2023. Në këtë kontekst, po theksoj se, për shkak të kohëzgjatjes së madhe seancës sonë, që kishte edhe dalje nga rendi i ditës, kësaj radhe, mendoj që mos të kemi pikën "eventuale"...? (Pajtohen të gjithë).

Pika e IV-të (katërtë) e rendit të ditës

Në kuadër të pikës së IV-të (katërtë) të rendit të ditës kemi miratimin e P/Vendimit për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara vetanake, nga vitet 2017 e 2018, në vitin 2019, siç e keni pasur në material..., hapim diskutimet...?

z.Sefidin Mejzini- Bartja e mjeteve të pa shpenzuara është çështje pozitive e ndarja e mjeteve prej 300 mij eurove është shumë e vogël vetëm për ujësjellësin qendror, pasi se edhe po të ndaheshin 3 milionë nuk do të ishin mjaft, pasi se në pyetje është uji i pijes për qytetarët tonë. Pra, fjala është për ujësjellësin qendror për 15 fshatra të Komunës. Sa i përket Zyrës së Prokurimit dhe procedurave, unë e kuptoj se është e mundur të gabohet një herë apo dy, por kurrsesi s'mund t'a kuptoj të gabohet 5 apo 6 herë, për të njëjtin Projekt. Mendoj se këta njerëz do të duhet të shkonin në burg, pasi se o e bëjnë të njëjtin gabim dhe athua nuk janë nga fshatrat si :Zgtari, Brruti... e në mënyrë konstante të bëjnë gabime e mos të kuptojnë rëndësinë e ujit të pijes, si çështje kryesore për qytetarët tonë? OSHPP, që disa herë, po e ndalon dhe anulon procedurat tenderuese, që do të thotë se diçka qëndron aty dhe dëshirojmë të dijmë se çka është në pyetje? Pra, dëshirojmë të dijmë se në bazë të të cilave procedura po dështon realizimi i Projektit e që kemi marr informatat se e njejtja kompani po ankohet në procedurat tenderuese e ne, si delegatë, duhet të njoftohem se çka është në pyetje dhe po ngjanë?! Athua se kompania e cila po ankohet ka të drejtë, pasi se jemi njoftuar se kompanit që konkurojnë duhet të plotësojnë kritere të caktuara dhe liçenca për veprimtari të ndryshme e njëri nga ato kritere është të ketë përvojë të gjatë në realizimin e projekteve në lëmin e furnizime me ujë të rrjeteve të ujsjellëseve. Nuk i shof ata njerëz që punojnë në atë Zyrë, por mund të them lirisht se qenkan persona të pa përshtatshëm apo të punësuar që punojnë në organe ekzekutive? Po ashtu, do të theksoja, se mjetet e ndara prej 10 mijë eurove, nuk mjaftojnë për komunitetin e fshatit tim-Kosavë, që do të kisha kërkuar mirëkuptimin e të gjithë juve që të merret parasysh projekti kur është në pyetje uji i pijes. Lidhur me shpronësimin, sipas nenit 9 të Ligjit,

komunat kanë të drejtën të bëjnë kompensime të caktuara të pronave, pasi se askush s'po kërkon që të ndërtohet fabrikë, por unë kam kërkuar vetëm një terren sportiv i cili do t'u ngel nxënësëve tonë, pasi se ajo pjesë e bukur atje ku pata theksuar në "Mejdan", është tani është përplotë me mbeturina ndërtimore.

z.Nexhat isufi- Po i përkujtoj delegatët se kur kemi kërkuar, shpesh-herë, kemi marr përgjigje se nuk lejohet ndryshimi i kodeve buxhetore e unë po theksoj se, kontejnerët që ne kemi aktualisht janë të demoluara në atë masë sa që nuk e kryejnë funksionin e tyre, e në anën tjetër, Komuna ka kompetenca për kompaninë e pastrimit dhe duhet t'a dijmë se mbeturinat nuk mund të mblidhen në një kontejner të dëmtuar, që do të kisha lutur delegatët, që në vendet kyçe, të vendosen kontejnerë me ndarjen e mjeteve për këtë qëllim, nga se kontejnerët janë shkatërruar nga vjetërsia e kohës së tyre. Ndoshta, kryetari i Komunës, do t'a shpreh të arsyeshme që të ndahen mjete të caktuara për këtë qëllim, pasi se nuk janë ndarë ato për këtë destinacion. E kemi kategorinë e bashkëpunimit me donatorë prej 100 mijë eurove dhe a është e mundur që nga aty të ndajhen mjete të caktuara, pasi edhe në shkollë e ambulanca kemi kontejnerë të tillë të dëmtuar, që do të ishte mirë të ndahen nja 10 mijë euro? Po ashtu, ka edhe një gabim teknikë të fshatit Kosavë, ku qëndron Kosovë, kurse për fshatin tim-Blaç janë ndarë 80 mijë euro për ndërrimin e rrjetit të ujësjellësit e që nuk mjaftojnë as për vendosjen e rrjetit, e lere më për punët tjera përcjellëse e që gjërat duhet kalkuluar e punët të kryhen mirë?

z.Munir Jonuzi- Nuk dua t'a komentoj shumë këtë P/Vendim dhe, sipas kodeve për bartjen e mjeteve, por desha të thekoj urgjencën e bisedimeve me qytetarët që ballafaqohen me këto probleme dhe propozoj ridestinin nën pikën 13 të rinovimi i shkollës së Brodit, ku janë paraparë 15 mijë euro dhe propozoj që të bëhet ndarja e tyre dhe atë, për rregullim të infrastrukturës në Krushevë me 5 mijë euro dhe kubëzimi dhe rregullimi i infrastrukturës në fshatin Zlipotok, me 10 mijë euro?

z.Zaim Hajredini- Mendoj se do të ishte më në rregull, që organet kompetente në foltore të japin sqarime e pastaj ne t'i kompenzojmë gjërat, pasi se kështu po këthehem, në pikën "0"?

z.Zinaida Elmazi- Unë kam një propozim lidhur me subvencionet prej 100 mijë eurove të Zyra e Kryetarit, që mendoj se nga këto mjete, një shumë e tyre, të lejohet për "Eko-Regjionin" e që të rregullohet gjendja lidhur me problemet e mbeturinave dhe deponive, pasi se po kërkojmë të jemi destinacion turistik e kështu jemi shëndërruar në destinacion të mbeturinave?!

z.Velid Haxhisin- Pajtohem plotësisht me kolegen Zinaida E. se kryetari dhe drejtori i DEFianncave është dashur të dalin në foltore, që të na sqarohen pozicionet e parapara për shpenzime dhe sipas kodeve. Ndërkaq, mjetet për investime kapitale janë paraparë ashtu, siç kanë qenë, por çka do të bëjmë me mjetet tjera për mallëra e shërbime, pasi se me rastin e shqyrtimit të raporteve 3-mujore kemi të bëjmë me shpenzime të mëdha e që, për çdo, vit prap po na ngelin mjete të mallërave e shërbimeve? Globalisht, llogarisim se kemi 66 mijë euro për mallëra e shërbime, përfshi këtu edhe Zyrën e Kryetarit dhe të Kuvendit. Për subvencione janë paraparë 130 mijë euro-100 mijë euro për Zyrën e Kryetarit e 30 mijë euro për DKRS-në, por që, prap, ngel dilema lidhur me ndërrimin e kodeve buxhetore të cilët janë kundërshtuar? Pra, nga cilat pozicione janë bartë mjetet për subvencionet e parapara? Për këto mjete, kryetari me siguri ka qëllime për të ndihmëmar me subvencione. Sa u përket propozimeve, natyrisht se edhe unë e përkrahi atë që të rregullohet ura në rrugën Krishevë-Restelicë, pasi se është projekt i pa

përfunduar, që mendoj se edhe kompania punëkryese është kompenzuar aq sa ka punuar, por që Projekti ka ngelur i pa plërfunduar dhe paraqet edhe rrezik për qytetarët. Sa u përket mjeteve të mbetura, mendoj se, të gjithë fshatrat kanë nevoja, pasi se kemi murin mbrojtës të pa kryer në Restelicë, nën shkollë. Pastaj, kemi mjetet e destinuar prej 10 mijë eurove që nuk mjaftojnë për atë mur mbrojtës, por që edhe fshatrat tjera kanë nevoja dhe, nëse edhe më tej është aktuale renovimi i shkollës së Brodit, të ndahen 50 mijë euro e të tjerat e të ngelin për shkollën?

z.Valon Shabani- Bartja e mjeteve të pa shpenzuara nga vitet paraprake është bërë sipas kërkesave të qytetarëve, kërkesave të drejtorateve dhe duhet ditur se, nëse fillojmë me kërkesa personale, t'a dini se nuk do të mjaftonin, jo 700 mijë euro por 7 milionë euro. Afro 90% të këtyre mjeteve të parapara janë ndarë për interesin e përgjithshëm të qytetarëve, për mallëra e shërbime 70 mijë euro, 10 mijë euro për Zyrën e Kryetarit dhe 6 mijë për procedurat e Zyrës së Prokurimit. Ne duhet të kemi edhe mjete të rezervuara për situata të pa planifikuara, siç ka ngjarë më 2018, kur janë pensionuar disa mësmdhënës. Mjetet për Zyrën e Kryetarit, ndoshta, bien në sy, por ato janë mjete të subvencioneve për të mirën e qytetarëve, pastaj janë në pyetje edhe marrveshjet e memorandumet e nënshkuar në emër të Komunës me donatorët, siç janë: UNDP-ja, Helvetasi etj. Ne kemi mundur këto mjete t'i redistinojmë nëpër drejtorate-si ai Bujqësisë, por memorandumet nënshkruhen nga kryetari i komunës. Te kultura kemi 30 mijë euro për t'u subvencionuar klubet sportive, garat e pehllivanëve dhe një shumë për përkrahjen e aktiviteteteve rinore. Te ujësjellësi po shifet se kemi një shumë të madhe e ne jemi të obliguar t'a mbulojmë këtë kategori, sepse, nëse fillojnë punimet ,ne nuk kemi mjete të siguruar të cilat do të na merreshin nga kodet tjera buzhetore dhe do të na paraqitet debalans buxhetor? Te shpronësimet, kjo shumë është siguruar për vendimet gjyqësore dhe, këtë vit, e kemi pasur fatin se përmbaruesit privat kanë marr 6 mijë euro, për dallim nga komunat tjera që kanë paguar për këtë edhe nga 30 mijë euro. Pra, këto mjete janë si garancion për epilogun e vendimeve gjyqësore. Mjetet tjera janë në bazë të marrveshjeve dhe asaj që kyretari të josh donatorët përmes sufinansimit dhe, nëse pajtoheni, nga kjo shumë, mund të ndajmë nja 10 mijë euro për sigurimine kontejnerëve. Te Bellobradi duhet të bëhet përmirësimi për rregullimine nyjeve sanitare të shkollës "Sezai Surroi" e shuma ngel e njejt. Te paisjet teknologjike është paraparë furnizimi me "lap-topa", projektor, makina fotokopjuese për administratën komunale dhe Kuvendin, siç mund të ndryshohet edhe kategoria për rinovimin e shkollës së Brodit e që, një pjesë e mjeteve, të shkon për urën në fshatin Krushevë.

z.Samidin Xheladini- Ne kemi obligim ligjor t'i parashikojmë këto mjete të mbetura, por që mos të ndodhin probleme, siç kanë ndodhur me realizimin e disa projekteve. Këtu e kam parasysh projektin e pasukseshëm në fshatin tim-Bresanë reth ujësjellësit e që kemi shpenzimet e panevojshme për muret mbrojtës dhe për përmbaruesin privat prej 60 mijë eurove. Për këtë, mendoj se ekzekutivi i komunës është, në kohën e fundit, që duhet të ndërmerr masa ndëshkuese ndaj punëkryesëve të cilat janë të pa përgjegjshëm dhe në mënyrë jo profesionale realizojnë projektet.

z.Hajrudin Hoxha- Te pika 123 lidhur me mjetet që duhen të barten për rinovimin e shkollës së Brodit, pajtohem që, 5 mijë euro të shkojnë për urën e pa përfunduar në Krushevë, por duhet ditur ky Kuvend se, në Restelicë, qytetarët vetë po punojnë reth ujësjellësit, që si projekt do të kushton 70 mijë euro. Unë u kam thënë se Komuna nuk ka mjete dhe se kemi vetëm 20 mijë euro për riparimin e

ujësjellësit të vjetër. Por, është për keqardhje se, në Restelicë ka ngjarë katastrofa e njohur natyrale dhe janë dëmtuar bazenët e ujit dhe kaptazhet e për këto probele ende po shukatet? Për këtë, unë 10 mijë euro do t'i propozoja për për ujësjellësin në Restelicë e 5 mijë euro për urën në Krushevë. Kështu, do të sanonim gjendjen që e kemi atje.

z.Naser Myrtezani- Meqenëse u theksua se pika "eventuale" nuk do të shqyrtohet, shfrytëzoj rastin t'i parashtroj një kërkesë kryetarit për rrugën Zaplluxhe-Lez-Prizren ku e dijmë se atje ekzistojnë 2 gropa e që do të ishte mirë të mendohej për to, që mos të kemi raste të bjer dikush në to?!

Kryetari- Më herët, drejtori i DEFinanca sqaroi se në cilën mënyrë duhet të shpenzohet mjetet e pa shpenzuara dhe ndryshimi i parë i këtij P/Vendimi ishte për Bellobradin me rregullimin e nyjeve sanitare të shkollës dhe propozimi dytë për mjetet e shkollës së fshtit Brod që duhet të orjentohej 10 mijë për fshatin Zlipotok dhe 5 mijë euro për urën e fshatit Krushevë.

Kryesuesi- Në rregull, kalojmë në votim për Itë P/Vendim dhe kush është "për"-14, "kundër"-1 dhe 0 vota të "përmbajtura", që konstatohet se me kiratuam këtë P/Vendim.

Pika e V-të (pestë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën dhe pikën e V-të të radhës e kemi P/Vendimin për ndërrim të palujtshmerisë së Komunës me pronën private të pronarit, për ndërtimin e shkollës në fshatin Buçe, që sqarime do të na jap kryetari z.Shaban Shabani- Siç e keni në tekstin e këtij P/Vendimi, ai është i bazuar në dispozita ligjore e fjala është për ndërrim të pa lujtshmerisë së pronës së Komunës me pronarin Vejsel Berisha nga Buçja, për ndërtimin e shkollës në këtë fshat. Ky ndërrim propozohet, nga se në fshatin Buçe nuk ka lokacion të nevojshëm për ndërtimin e shkollës së re dhe e vjetra nuk i plotëson kushtet mësimore. Pas marrjes së Vendimit të Kuvendit, për realizimin e këtij qëllimi, vlerësimin do t'a bënë Komisioni adekuat i MEFinanca dhe, paraprakisht, është bërë verifikimi i parcelave. Pas përfundimit të të gjitha procedurave, në organet ekzekutive të komunës, ngel obligimi për sigurimin e mjeteve të nevojshme për ndërtimin e objektit shkollor në këtë fshat.

z.Laurat Krasniqi- Pas sqarimeve të kryetarit dhe mos prezencës së pronarit të parcelës private në seancë, më lind dyshimi se, ndoshta, pronari i parcelës mund të ndërron mendjen e që ne, si delegatë, mund të vijmë në situatë të palakmueshme? S'di se sa ne, si delegatë të Kuvendit, do të votojmë dhe vendosim lidhur me pronën private e ai nuk është prezent këtu?

z.Refik Latifi- Paraqitja ime ka të bëjë me atë se unë, parimisht, jam për këtë P/Vendim, pasi se ky proces do t'i shërben interesit të Komunës dhe qytetarëve. Por, diskutimi i im ka të bëjë me bazën ligjore të këtij P/Vendimi, pasi se nuk është në harmoni të plotë me bazën ligjore? Kur e theksoj këtë kam sqarimet e mia se, në nenin 6 paragrafi 3 i Ligjit 04/L-144 ku bazohet P/Vendimi, nuk ka asgjë me P/Vendimin që po e shqyrtojmë, pasi se ai nen ka të bëjë me shfrytëzimin afatgjatë të pronës? Te nenet 11 e 13 i Ligjit sqarohet kjo çështje ku bëhet fjalë për ndërrimin e pronës së Komunës me personat fizikë e juridik, ku "komuna ka të drejtën e ndërrimit të palujtshmerisë me personat fizikë e juridik në rastet e të drejtave të barabarta dhe, kur është në pyetje interesi publik". Pra, Vendimi për iniciativën e ndërrimit duhet të sipas kushteve paraprake, siç janë: ndërrimi duhet të inicohet nga ana e Komunës e jo nga

pronari privat dhe vjen në shprehje vetëm për interes publik dhe, nëse nevoja për këtë ndërrim arsyetohet me planin e zhvillimit të Komunës dhe se Komuna nuk ka parcelë të përshtatshme për këtë destinacion. Për këtë, kryetari i Komunës i propozon Kuvendit ndërrimin e pronës komunale me personat fizikë. Këtë e theksoj nga se baza ligjore qëndron te neni 11 e jo 6 i Ligjit. Këtë e theksova që, më vonë, mos të kemi vërejtje me rastin e shqyrtimit të ligjshmërisë së këtij P/Vendimi.

z.Zinaida Elmazi- Dje në KP Fiananca e shqyrtuam këtë P/Vendim dhe nuk jam kundër ndërtimit të shkollës në këtë fshat, por e kam dhënë një propozim për kryetarin dhe kryesuesin, pasi se mua kjo Kërkesë më duket jo serioze? Ne duhet të dijmë saktë se pronari është i pëlqimit për këtë dhe pse nuk e keni edhe Pëlqimin e tij, përfshi edhe letërnjoftimin. Këtë po e theksoj se, edhe më herët, kemi pasur raste të ngjajshëm, si ky, e pastaj na kanë dalë probleme? Prandaj, unë këtë P/Vendim nuk do t'a votoj sot, nga se nuk e kemi Pëlqimin e pronarit dhe, nëse nuk është çështje e ngutshme, mund të shtyhet për seancë tjetër?

z.Velid Haxhisin- Edhe unë pajtohem se ky P/vendim duhet të përkrahet, pasi se nuk kam interes më të madh shoqëror se sa ndërtimi i shkollës dhe më vjen mirë që zotëri në fjalë paska shprehur këtë gatishmëri për ndërrim. Besoj se kjo nuk jetë vetëm deklarativisht, që kos të kemi raste që vendimet të na shpallen të kundërligjeshme.. Siç e kam vërejtur, për ndërtimin shkollës nevojitet 718 m/2 e që pastaj vlerësimin të bëjë Komisioni përkatës, që besoj se ai nuk do të dëmton as pronarin e as Komunën. Sidoqoftë, duhet përkrahur këtë, nga se është në pyetje interesi për ndërtimin e shkollës së fshatit.

z.Samidin Xheladini- Edhe ne (LDK) po ashtu jemi të pajtimit për votimin e këtij P/Vendimi, por duhet respektuar bazën ligjore, sipas mendimit të zyrtarit ligjor, që mos të vijmë në situatë se kemi vepruar gabimisht?

z.Nexhat Isufi- Kërkesa e DK Arsimit është që të ndërtohet shkolla, nga se nuk ka sipërfaqe të mjaftueshme për ndërtimin e saj dhe, sipas Kërkesës së kryetarit, sot e kemi edhe P/Vendimin për ndërrim të pronës komunale me të pronarit privat dhe, nëse ka gabime e shkelje ligjore, ato duhet eliminuar, pasi se Komuna ka nevojë për një shkollë të tillë, edhe pse do të ishte mirë të ishte prezent këtu edhe pronari i parcelës private. Me rëndësi është miratimi i Vendimit nga Kuvendi, kurse procedurat e mëtejme vazhdojnë.

z.Zaim Hajredini- Më vjen mirë që këtë pikë e kemi në rend dite, nga se është me rëndësi që të ndërtohet shkolla e fshatit e cila, vërtetë, është vjetëruar. Me këtë hap, ne u krijojmë kushte më të mira mësimore nxënësve dhe mësuesve dhe, kisha kërkuar nga kompetentët, zgjidhjen e probleme formale ligjore në aspektin pronësor-juridik. Pajtohem me parafolësit se, nëse ka pasur gabime në procedurat ligjore të nëneve, kjo të evitohet, kurse pres nga Komisioni Vlerësues i Pronës që të vepron pozitivisht dhe, sipç po e shohim në P/Vendim, parcelat nuk janë të shprehura me shifra dhe janë të të njëjtës sipërfaqe, që besoj se nuk do të dëmtohet, asnjëra palë?

Kryetari- Ju falënderoj në bindjet tuaja pozitive dhe po theksoj se pronari i parcelës e ka dhënë Pëlqimin paraprak gojor. Por, sidoqoftë, pas miratimit të Vendimit, për këtë fjalën e fundit e ka MAPL-ja e

cila vlerëson ligjshmërinë dhe, nëse ka nevojë, mund të kërkojmë edhe Pëlqimin me shkrim të pronarit të parcelës private, që Komisioni i MEFinanca të vepron drejtë dhe pa dëmtuar asnjërën palë.

Kryesuesi- Në rregull, kalojmë në votim dhe kush është "për"-14, "kundër"- 0 dhe 1 votë "e përmbajtur", që konstatoj se miratum P/Vendimin e këtill.

Pika e VI-të (gjashtë) e rendit të ditës

Edhe në kuadër të kësaj pike, që do të jetë e fundit, pasi se atë "eventuale" e shtymë dhe, në njëfar mënyre, përfshim shumë çështje reth saj, ka të bëj, prap, me P/Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të të pronës shoqërore për ndërtim të vathës verore, siç është në P/Vendim në ZK në Restelicë, me procedurë të konkurimit..., që, fillimisht, fjalën e ka kryetari z.Shaban Shabani- Ky P/Vendim, në realitet, është një propozim nga realizimi i Planit Zhvillimor të Komunës për nxitjen e zhvillimit të bujqësisë e blegëtorisë me investime në këto fusha në territorin tonë. Ju jeni në dijeni se Komuna ka pasur mjaft prona në pronësi të paluajtëshme dhe qëllimi i këtij P/Vendimi është që ato prona, prap, të rikthehen në pronësi komunale me qëllim që të delet në ndihmë nevojave të bujëve e blegotërëve tonë, si lëmi kryesore për zhvillim të komunës sonë. Por, po theksoj se, pos kësaj parcele që e kemi në shqyrtim, parcelat tjera janë në kontest gjyqësor me AKPronës, që lidhur me këtë parcelë kemi të drejtën e dhënies në shfrytëzim afatgjatë dhe qëllimi është i mirë. Ky proces do të zhvillohet përmes procedurave të ankandit publik nga zyrat përkatëse dhe në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi.

z.Rexhep Kamberi- Të jem i qartë se unë do të përkrahi këtë iniciativë nga arsyeja se, dje, në KKomunitet, drejtori i DUrbanizmit, detalisht, na ka njoftuar për gjendjen lidhur me këtë, se kjo parcelë mund të jepe në shfrytëzim afatgjatë nga bujqit-blegtorët e këtushëm dhe se, pjesët tjera të pronës sonë komunale, siç theksoi edhe kryetari, janë ende në kontest me AKP-në. Do t'a përkrahja këtë P/Vendim pasi se do të jetë, kryekëput, për bujqësi-blegëtori, si dhe nënkryetari i Komunës për komunitete ka dhënë garanca se ashtu do të jetë, si dhe nga fakti se investuesit potencial do të kanë dëshirën për të investue te ne? Në këtë kontest, kur përmendet investimet këtu dhe riatdhesimi, do të theksoja çështjen e punësimit të zyrtarit për këthim në ZLKKthimit dhe, pyes kryetarin, se si është e mundur që në atë pozitë të pranohet banori i komunë së Prizrenit e dihet se ajo pozitë i takon komunitetit jo shumicë, përkatësisht komunitetit Goranë? Ne dijmë se, në Konkurs, kanë qenë të paraqitur më shumë kandidatë, me përgatitje të lartë, nga Vraniçi, Rapça, Krusheva etj. dhe se ata nuk kanë kaluar testin dhe se është pranuar personi nga komuna e Prizrenit, kurse në mesin e kandidatëve ka pasur edhe të gjinisë femërore?! Prandaj, athua jemi komunë aq e pasur, edhe pse dihet se sa të papunë kemi ne këtu e të sillen-importohen punëtorë nga komuan fqinje e Prizrenit?! Me një sjellje të këtill ndaj kuadrove tona, atyre nuk u ka ngel asgjë, pos që të përgatiten e të shkojnë në migrim jasht vendit, apo të shkojnë në Prizren e atje të kërkojnë punë?!

z.Hajrudin Hoxha- Që në fillim po theksoj se këtë P/Vendim dhe se, praktikisht, e dijmë, me emër e mbiemër, personin i cili është në pyetje për këtë investim? Ndërkaq, ky P/Vendim parashihet të jetë për 99 vjet shfrytëzimi të pronës shoqërore. Unë jam nga Restelica dhe në dokumentin-Listën Poseduese qëndron "Zagradaska Hoqa" dhe unë nuk e di se ku është ajo pronë, apo është fjala për gabim: Po ashtu, këtu qëndron "pronë-rrugë e pakatgorizuar" dhe nuk e di se ku është, por ajo që më intereson është se paska të interesuar për investime, kurse dihet se shumica e të tjerëve nga komuna jonë po e lëshojnë

vendlindjen e ne tani, me këtë hap, po dëshirojmë nxitjen e zhvillimit në lëminë e bujqësis-blegëtorisë, por që duhet mënjanuar paqartësitë që u theksuan?

z.Zinaida Elmazi- Fillimisht do të parashtroj një pyetje për të cilën kërkoj përgjigje nga kryetari, pasi se këtu theksohet se do të aplikohet tenderimi dhe se a mund të aplikojnë blegëtorët e komunave tjera, apo vetëm nga Komuna jonë? Dhe nëse përgjigja do të ishte-të gjithë, unë e kam një sqarim se ne këtu jemi për respektim të ligjeve dhe për vendime ligjore dhe, thjesht, më brengos se pse, pothuaj gjithmonë, po na jepet në dorë "patatja e nxehtë" dhe pse na sillen P/Vendime të këtilla për të cilët nuk është kompetent Kuvendi?! Sipas këtij P/Vendimi përmendet parcela e cila është në zonën e II-të PN "Sharri" dhe, nëse ka marr përgjigje nga PN "Sharri" për rastin e hidrocentralit në Brodit, atë t'a kemi në dijeni edhe ne, nëse është kompetent PN "Sharri"? Pra, kërkesat e këtilla është dashur t'i adresohen PN "Sharri" dhe nuk ka nevojë që ne të vendosim për këtë çështje?!

z.Velid Haxhisin- Ky P/Vendim është i arsyeshëm për shumë arsye. Arsyeja e parë është se bazohet në PZhvillimor të Komunës ku bujqësia-blegësia janë bazë e zhvillimit dhe se, prezenca e blegtorëve në PN "Sharri", vetëm mund të hijeshon Parkun e jo t'a rrezikon?! E dyta, unë mendoj se e gjithë procedura nga DUrbanizmit është bërë me rregulla, por ne nuk e dijmë, saktësisht, se për cilat parcela është fjala, pasi se, para nesh, e kemi skicën e cila është e përgjithësuar? Unë, personalisht, nuk kam mundur të gjendem në situatë të tillë dhe me ato kordinata, por që dua të përsërisë se investimet në blegëtori t'i kemi prioritet, që janë si për mu edhe për subjektin tim politikë-Vakat. Por, jam skeptik lidhur me afatin e shfrytëzimit për 99 vite, që mendoj se është i gjatë, pasi se nevojat e Planit Zhvillimor mund të ndyshojnë, me kohën, dhe se blegësia mund të ketë ndryshime kohore, që ndoshta, është dashur të bëhet shkurtimi i afatit 30-40 vjet, siç do të vendos ky Kuvend? P/Vendimin e përkrahi më së shumti nga aspekti se bujqësia-blegësia janë hallka e fundit e cila ofron mundësi të për ndalesën e migrimit të popullatës dhe nxitjes së zhvillimit.

Kryetari- Siç u teksua në diskutimet e delegatëve para meja, që i përkrahi edhe unë, është ajo se parcela është pronë e Komunës së Dragashit, por se ajo gjendet në kuadër të PN "Sharri", që do të thotë se menaxhimi bëhet në kuadër të këtij parku, që është obligim i mbikqyrjes nga drejtori e Parkut. Kjo do të thotë se ne, me këtë P/Vendim, dëshiroj t'i ndihëmojmë bujqësisë-blegëtorisë, për qëllime të zhvillimit tonë, kurse kushtet e veprimit atje do t'i cakton drejtorati i PN "Sharri". Nga materiali shifet se shfrytëzimi parashihet të jetë afatgjatë-99 vjet e që mund të mos jetë ashtu, por afati mund të jetë 50 apo 40 vjet, siç do të vendos ky Kuvend?

Kryesuesi- Kemi propozimet që kohëzgjatja e shfrytëzimit të jetë në 40 vjet dhe të kalojmë në votim, për 40 vjet...? Kush është "për"-11, "kundër"-3 dhe të "përmbajtura"-3 vota, që konstatoj se miratuar këtë P/Vendim, për 40 vjet shfrytëzimi.

z.Hatixha Sheh- Nuk e kishim të qartë, a votuam për afatin e shfrytëzimit, apo në tërësi, për P/Vendimin?

Kryesuesi- Në rregull, po përsërisim, edhe një herë, dhe kush është për shfrytëzim 40 vjeçar...? "Për"-13, "kundër"-1 dhe 3 vota "të përmbajtura", që pra jepet në shfrytëzim aftagjatë-40 vjeçar.

Meqenesëe pikën "eventuale" e shtymë, nëse nuk ka edhe diçka për t'u theksuar, me kaq, përfundam seancën e sotme të Kuvendit.

E përgatiti :

Shërbimi i Kuvendit Komunal

Kryesuesi :

Betim Merdiu